



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK Nr. Prot. 01-3343/15
Dep. 03 Prot. No. 16.10.2015
Nr. lfaq. 03 Data 16.10.2015
Broj stranica 03 Datum 16.10.2015
Nr. pages 03 Date 16.10.2015

DATË/A:	16.10.2015
REFERENC-Ë:	DPK- DPKPP-03-03-2753/15
PËR/ZA/TO:	z. Behram ABAZI Drejtor i Drejtoratit për Prokurime të Veçanta në Agjencinë Qendrore të Prokurimit
CC:	z. Mursel RRACI Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë Qendrore të Prokurimit
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull " Shërbimet Hoteliere të Gastronomisë Ushqim dhe Pije – ritender "



Inderuari z. Abazi,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin " Shërbimet Hoteliere të Gastronomisë Ushqim dhe Pije – ritender " me numër prokurimi: AQP-AK-15-002-211, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoriteti Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull " Shërbimet Hoteliere të Gastronomisë Ushqim dhe Pije – ritender " me numër prokurimi: AQP-AK-15-002-211, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042.

Arsy etimi

Në bazë të informatës së pranuar me dt.09.09.2015, Agjencia Kundër Korrupsionit ka iniciuar procedurën për trajtimin e rastit me nr. të rastit AKK-03-03-2753/15 që për objekt trajtimi ka pasur tërë aktivitetin e prokurimit publik me titull “ **Shërbimet Hoteliere të Gastronomisë Ushqim dhe Pije – ritender** ” me numër prokurimi AQP-AK-15-002-211 i iniciuar nga Agjencia Qendrore e Prokurimit.

Agjencia kundër Korrupsionit me dt.15.09.2015 ka paraqitur kërkesën për dokumentacion pranë Autoritetit Kontraktues përmes së cilës ka kërkuar tërë dokumentacionin e këtij aktiviteti të prokurimit pasi që Komisioni vlerësues të përfundoj me ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve. Me dt.29.09.2015 Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar tërë dokumentacionin në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, ku dhe pas shqyrtimit të të njëjtit ka konstatuar faktet si në vijim:

Drejtorati për Prokurime të Veçanta në kuadër të Agjencisë Qendrore të Prokurimit me kërkesë të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Administratës Publike ka iniciuar procedurën e prokurimit ku ka paraparë Shërbimet Hoteliere të Gastronomisë Ushqim dhe Pije për dy Institucionet publike në fjalë. Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, kontratë të llojit shërbime me vlerë të madhe të kontratës si dhe e ka ndarë në dy lote (pjesë) ku në lot 1 Shërbimet Hoteliere të Gastronomisë ushqim dhe pije në ndërtesën e kuvendit të Republikës së Kosovës dhe në lot 2 Shërbimet Hoteliere të Gastronomisë ushqim dhe pije në ndërtesën e ish gjërmisë .

Duke u bazuar në regjistrin e Operatorëve ekonomik që e kanë pranuar dosjen e këtij tenderi dhe Procesverbalin e hapjes së tenderit për këtë tender dosjen e kanë tërhequr 8 Operator ekonomik, ndërsa 2 prej tyre i kanë dorëzuar ofertat e tyre për të dy lotet (pjesët).

Komisioni për ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve pasi ka vlerësuar të dy ofertat e Operatorëve ekonomik ka konstatuar se të dy tenderuesit kanë dorëzuar oferta të përgjegjshme, andaj ka rekomanduar që për lot 1 kontrata t'i ipet Operatorit ekonomik të identifikuar me nr. 2 në raportin e vlerësimit të tenderëve pasi ka ofruar çmimin më të ulët, ndërsa për lot 2 është rekomanduar për kontratë Operatori ekonomik i identifikuar me nr.1 në raportin e vlerësimit të tenderëve.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka ekzaminuar dhe analizuar me kujdes ofertat e të dy Operatorëve ekonomik që kanë ofertuar për dy lotet konstaton se të 2 Operatorët ekonomik e kanë fituar nga një lot. Sipas Agjencisë kundër Korrupsionit Operatori ekonomik i cili është rekomanduar për kontratë për lot 1 nga ana e Komisionit vlerësues është i papërgjegjshëm pasi që në pjesën C tek formulari i dorëzimit të tenderit ku është kërkuar validiteti i tenderit të

jetë prej 120 ditësh nga afati i fundit për dorëzimin e tenderëve i njëjti nuk ka ofruar validitet të tenderit.

Autoriteti Kontraktues me dt.15.10.2015 ka formuar një Komision të veçantë për hapjen e një kopje të ofertës së Operatorit të rekomanduar për lot, ku me këtë rast ka qënë si vëzhgues gjatë hapjes së kopjes edhe Zytari i Agjencisë kundër Korrupsionit me ç'rast është konstatuar se edhe në kopjen e të njëjtit mungon validiteti i tenderit. Sipas Legjislacionit në fuqi për Prokurimin Publik Operatorët ekonomik të cilët nuk ofrojnë validitet të tenderit konsiderohen sikur të mos aplikojnë fare dhe si të tillë duhet të refuzohen si të papërgjegjshëm.

Konsiderojmë se veprimet e Autoritetit Kontraktues bien ndesh me nenin **59** Ekzaminimi, krahasimi dhe vlerësimi i tenderëve të Ligjit për Prokurimin Publik, nenin **15** Vlefshmëria e tenderit të Rregullores për Prokurimin publik dhe nenin **28** Validiteti i tenderit të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Si përfundim Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se vetëm njëri nga Operatorët ekonomik i plotëson kërkesat konform Dosjes së këtij tenderi dhe si i tillë është i përgjegjshëm për të dy lotet, andaj meqenëse ka më pak se dy Oferta të përgjegjshme, AKK rekomandon anulimin e procedurës së prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të mos lejohen shkeljet e tilla në procedurat e prokurimit.



Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra

Me respekt !